



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.18.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prizrenit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Faruk Rrahmani, i mbështetur nga, Florim Maliqi (Udhëheqës Ekipi), Agim Sogojeva dhe Nebojsa Ristiç.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	29
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	32

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Prizrenit për vitin 2013 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë, Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë e reflekton qasjen e paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 01.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memorandumin e Planifikimit të Auditimit;
- Reagimin ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës së Prizrenit (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### *Theksimi i çështjes*

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat e shpalosur mbi pasuritë fikse nuk ishin të plota dhe të sakta. Në regjistrin e pasurive nuk ishte përfshirë një automjet i pranuar si donacion nga Ministria e Administratës Publike dhe tetë pajisje të teknologjisë informative ishin regjistruar pa vlerë të blerjes.

**(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

- Sistemi aktual i kontrolleve të brendshme nuk ofron siguri të mjaftueshme që menaxhmenti të përmbush në mënyrë të suksesshme të gjitha objektivat e saja. Lidhur me gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrolleve, në raportin e vitit të kaluar, ishin dhënë 16 rekomandime, prej të cilave Komuna kishte adresuar tre, ndërsa të tjerat, ose ishin në proces ose nuk ishin adresuar fare. Ky fakt është një tregues se Menaxhmenti i Komunës nuk i kishte kushtuar vëmendjen e duhur korigjimeve të mangësive ekzistuese;
- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2013 ishin përgatitur më mirë se në vitin 2012, ato ende nuk ishin të plota dhe të sakta. Disa prej gabimeve janë ndryshuar në versionin final, por menaxhmenti nuk arriti të korigjoj të gjitha zërat. Si të pa korigjuara mbetet çështja e mos prezantimit të drejtë të obligimeve të mbetura në fund të vitit 2013, si dhe prezantimi jo i plotë i pasurive;
- Menaxhimi i të hyrave duket të jetë problemi kyç për Komunën. Gjatë vitit 2013 ishte shënuar një rënie të të hyrat vetanake prej 319,352€ apo 7% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa llogaritë e arkëtueshme kanë kaluar shifrën mbi 11.6 milion euro. Menaxhmenti duhet të ketë në fokus me prioritet të lartë trajtimin e këtij problemi;
- Problem tjetër i rëndësishëm që vazhdon të përsëritet prej vitit në vit është edhe rritja e obligimeve. Detyrimet e papaguara në fund të vitit kishin shënuar shifrën 4,572,000€. Në këtë vlerë bënin pjesë rreth 45% detyrimet kontingjente;
- Në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë janë vërejtur tejkalime në numrin e të punësuarëve dhe si rezultat i kësaj, kanë lindur vështërsi në pagesat e pagave të tyre për shkak të limiteve buxhetore;
- Dobësitë sistematike ekzistojnë në fushën e prokurimit, që nga zotimi i fondeve, ndjekja e procedurave të prokurimit e deri te menaxhimi i kontratave. Procesi i

menaxhimit të kontratave është përcjell me kontrolle joadekuate, raporte pa specifikacione të qarta si dhe mungesë të pranimit teknik të punëve të kryera; dhe

- Komuna kishte shënuar një progres në regjistrimin e pasurive, krahasuar me vitin paraprak, po ajo që mbetet të bëjë menaxhmenti, është regjistrimi dhe vlerësimi i plotë i pasurisë deri në fund të vitit 2014. Në këtë kontekst edhe azhurnimi i regjistrit të pasurive me të gjitha informatat e nevojshme.

Edhe pse arritëm të marrim siguri nga kontrollet në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin kanë vu në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në fushën e prokurimit, realizimin e buxhetit, inkasimin e të hyrave, subvencioneve dhe transfereve si dhe evidentimi i pasurive jofinanciare.

#### **Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë se, Kryetari duhet të:**

- Sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;
- Bëhet një analizë e detajuar e të hyrave për vitin 2013 për të siguruar plotësinë e pranimeve dhe për të siguruar që një proces i fuqishëm është funksional për të përcaktuar rrjedhat e mundshme të të hyrave në vitet e ardhshme;
- Aktivizoj mekanizma adekuat për çështjet e inkasimit të të hyrave, ndarjes së subvencioneve si dhe evidentimin e pasurive me informata të plota dhe të sakta me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të këtyre fushave në të cilat janë vërejtur mangësi menaxheriale;
- Analizoj arsyet pse ishin lidhur kontrata pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve sidomos në tre muajt e fundit 2013, dhe që kontrollet ekzistojnë ose janë aplikuar për të siguruar që procedurat e prokurimit zhvillohen vetëm atëherë kur janë në dispozicion burimet e mjeteve; dhe
- Se gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport, do të merren në konsiderim, të diskutohen dhe adresohen në të gjitha nivelet e menaxhimit me qëllim të forcimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në tërë Komunën.

#### **Përgjigja e menaxhmentit - Auditimi 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

---

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komunës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) mbi PVF.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ(ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar(ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

#### *Opinion i Pamodifikuar<sup>1</sup> me theksim të çështjes*

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### *Theksimi i çështjes*

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat e shpalosur mbi pasuritë fikse nuk ishin të plota dhe të sakta. Në regjistrin e pasurive nuk ishte përfshirë një automjet i pranuar si donacion nga Ministria e Administratës Publike dhe tetë pajisje të teknologjisë informative ishin regjistruar pa vlerë të blerjes.

**(SNISA 200: Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.



## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, janë identifikuar dy rreziqe domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive dhe pagesave nga palët e treta. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive materiale në lidhje me prezantimin e pasurive dhe pagesave nga palët e treta ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarr veprime të duhura për të adresuar rreziqet e ndodhura.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1: Raportim jo i plotë mbi pasuritë

Pasuritë në pronësi të komunës me vlerë mbi 1000€ nuk ishin regjistruar plotësisht në regjistrin e pasurive, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e PVF.

### E gjetura

Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimet që nevojitet të ndërmerren për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar nga se menaxhmenti nuk ka arritur të zbatoj përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar se vlera e pasurive në PVF nuk ishte e saktë.

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të identifikoj veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësoj një prezantim të drejtë dhe të saktë të pasurive në vitin 2014.

#### Çështja 2: Pagesat nga palët e treta

### Rreziku është identifikuar por nuk ka ndodhur

Rreziku i anomalive që ne kemi identifikuar në fazën e planifikimit në lidhje me shpalosjet dhe prezantimin e pagesave nga palët e treta nuk ka ndodhur.

### Përgjigja e Auditimit

Pagesat e Ministrive për Komunën janë qartësuar me rregulloren e re të Thesarit nr. 03/2013 të datës 31.12.2013, dhe ato nuk trajtohen më si pagesa nga pala e tretë pasi janë pagesa nga Llogaria e vetme e Thesarit.

Ne kemi shqyrtuar informatat e Komunës në lidhje me pagesat e palëve të treta dhe mund të konstatojmë se këto informata janë prezantuar drejtë.

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike nr. 03/L-048;
- PVF-të janë nënshkruar nga ZKA (Kryetari i Komunës) dhe ZKF;
- PVF-të janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministri të Financave (MF) në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna kishte përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore te Kuvendi Komunal dhe një kopje në MF gjatë vitit 2013.

Në draft pasqyrat financiare fillestare të Komunës janë vërejtur disa mangësi për të cilat ishte e nevojshme të bëheshin disa korrigjime, pasi nuk ishin në përputhje me Rregullën Financiare nr.03/2013.

Megjithatë, përkundër insistimit tonë, edhe pas përmirësimeve dhe korrigjimeve, disa çështje të raportimit mbetën të pandryshuara.

### Çështja 3 - Prezantimi i Pasqyrave Vjetore Financiare - Prioritet i lartë

**E gjetura** Në shënimin 28: Shpalosja e detyrimeve në fund të periudhës, komuna nuk kishte shpalosur gjendjen reale të detyrimeve të papaguara sidomos për kategorinë e pagave. Detyrimet në PVF ishin prezantuar në shumë prej 213,000€, ndonëse ato duhet të ishin 211,933€; dhe

Në nenin 30: Pasqyra mbi pasuritë jofinanciare nuk ishte e plotë, ngase regjistri i pasurive nuk ishte azhurnuar me informata mbi vlerën e pasurive të pranuar si donacion. Rasti ishte me pranimin e automjetit tip Mitsubishi si donacion nga Ministria e Administratës Publike. Po ashtu, regjistrin të pajisjeve të teknologjisë informative i mungonte vlera e blerjes për tetë monitor.

**Rreziku** Mangësitë e evidentuara te pasuritë dhe detyrimet bartin rrezikun e raportimit jo të drejtë të PVF-ve për vitin 2013, me ndikimin që kërkesat statusore mbi PVF të mos përmbushen.

**Rekomandimi 2** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2014 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë lidhur me përgatitjen e tyre, përkatësisht Rregullës Financiare 03/2013, si dhe të siguroj se ekziston linja raportuese dhe stafi menaxhues është i përgjegjshëm me rastin e raportimit të të dhënave financiare të ZKF.

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm. Ne kemi vërejtur se ishin përmbushur kërkesat si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në MF;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë; dhe
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF.

Ndërsa nuk ishin përgatitur Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollës (MFK) dhe Raporti vjetor i performancës.

**Rekomandimi 3 Prioritet mesatar** - Kryetari duhet të siguroj se kërkesat e raportimit të jashtëm janë përmbushur plotësisht për të arritur një raportim efektiv të Komunës, konform kornizës së raportimit të jashtëm.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të Komunës ka rezultuar me 16 rekomandime kryesore. Pavarësisht zbatimit të një plani të veprimit për të adresuar rekomandimet e vitit 2012 - një numër çështjesh të rëndësishme mbeten ende për t'u adresuar. Megjithatë, menaxhmenti ka bërë përpjekje për implementimin e rekomandimeve. Për një përshkrim të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

---

#### Çështja 4 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm tre, prej rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht, nëntë ishin në proces, ndërsa katër nuk janë zbatuar deri në kohën e auditimit. Menaxhmenti nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Është e rëndësishme të theksohet se menaxhmenti nuk e ka dërguar raportin e auditimit të vitit të kaluar për diskutim në Kuvendin Komunal.

**Rreziku** Mungesa e një procesi formal për të menaxhuar zbatimin e rekomandimeve ndikon në joefikasitetin e organizatës. Si pasojë e kësaj mund të kemi përsëritje të mangësive të njëjta nga viti në vit. Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet kyçe financiare kanë rezultuar në:

- Joefikasitet të vazhdueshëm për të realizuar vlerë të mirë për para; dhe
- Mos përmirësimin e kontrolleve që lidhen me të hyrat vetanake.

**Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet nga Kryetari në baza mujore.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo nuk po zbatohen në praktik dhe nuk po funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Ne kemi vërejtur se Komuna nuk e ka marrë në konsideratë vetë-vlerësimin në kuadër të MFP në lidhje me vlerësimet e PEFA-s dhe vetë-vlerësimin e KBFP.

Ne kemi gjetur se, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që Komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë forcimi i kontrolleve të Pagat dhe Mëditjet, Prokurimi, Subvencione dhe të hyrat vetanake.

## 4.1 Qeverisja e mirë

### Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur të menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

---

### Çështja 5 - Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë

**E gjetura** Ne rishikuar format e kontrolleve menaxheriale që zbatohen në Komunë, si nga aspekti i të hyrave ashtu edhe të shpenzimeve. Format i aplikuar i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth dallimeve në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë monitoruar në baza mujore. Fakti se gjatë vitit 2013, ishin paguar fatura nga viti paraprak, si rezultat i mos raportimit me kohë të obligimeve, flet se linja raportuese nuk ka funksionuar si duhet.

**Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar të menaxhmenti i lartë i vështirëson menaxhmentit monitorimin në mënyrë aktive të aktiviteteve të organizatës. Mungesa e raportimit të drejtë për të gjitha shpenzimet, përkatësisht për faturat e papaguara në kohë të ndodhjes, rrit rrezikun që projektet e vitit aktual të mos realizohen.

**Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të organizoj një rishikim të aspektit të raportimit nga drejtoratet përkatëse për të përcaktuar formën e raportimit e cila mundëson menaxhmentit vendim marrjen e duhur dhe me kohë mbi mbarëvajtjen dhe monitorimin e proceseve.

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>33,628,746</b>	<b>35,157,505</b>	<b>31,780,415</b>	<b>30,274,489</b>	<b>32,018,274</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	27,509,666	27,614,666	27,324,442	25,683,770	26,073,953
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	0	1,114,900	887,220	976,455	1,436,952
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	6,119,080	6,119,080	3,364,987	3,317,382	3,892,448
Donacionet e brendshme	0	219,777	153,878	125,610	167,400
Donacionet e jashtme	0	89,082	49,888	171,272	447,521

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 1,528,759€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme në shumë prej 308,859€ dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë prej 1,114,900€. Pjesa tjetër prej 105,000€ është rritur sipas vendimeve të Qeverisë.

Buxheti është shpenzuar rreth 90% në nivel të përgjithshëm. Ndikimin kryesor në këtë përqindje të ultë të ekzekutimit e bën shkalla e dobët e inkasimit të të hyrave vetjake, vetëm 65% në krahasim me planifikimin buxhetor.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Të hyrat e planifikuara dhe të inkasuara në vitin vijues.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit ( € )**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>33,628,746</b>	<b>35,157,505</b>	<b>31,780,415</b>	<b>30,274,489</b>	<b>32,018,274</b>
Pagat dhe Mëditjet	14,925,000	15,151,374	15,139,595	14,856,794	14,403,387
Mallrat dhe Shërbimet	3,051,116	3,156,268	2,585,716	2,082,843	2,133,269
Shërbimet komunale	841,861	841,861	804,029	802,795	638,218
Subvencionet dhe Transferet	535,979	535,979	504,157	350,288	351,636
Investimet Kapitale	14,274,790	15,472,023	12,746,918	12,181,769	14,491,764

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me atë fillestar ishte rritur me rishikim të buxhetit për 1,197,233€, ndërsa shkalla e shpenzimeve për këtë kategori ishte 82% nga buxheti. Ky buxhet është planifikuar të shpenzohej për projektet në vazhdim dhe për projekte të reja;
- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 226,374€ dhe Mallra dhe Shërbime për 105,152€ është si rezultat i pagesave për kujdestari në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Rritja e buxhetit për Mallra dhe Shërbime ishte bërë me qëllim të mbulimit të borxheve të mbetura nga viti paraprak. Përkundër kësaj, niveli i borxhit në fund të vitit për këtë kategori ishte 283,000€. Buxheti për shërbimet komunale nuk kishte ndonjë ndryshim nga buxheti fillestar, mirëpo në kuadër të kësaj kategorie kishin mbetur mjete të pa shpenzuara shuma prej 37,832€, ndërsa në fund të vitit obligimet e paguara për këtë kategori ishin 135,000€;
- Komuna ka pranuar gjithashtu grande nga donatorët vendorë dhe të jashtëm në vlerën 308,859€, të cilat ishin alokuar për investime kapitale të bashkëfinancuar në projektet lidhur me ndërtimin e infrastrukturës rrugore, prej të cilave ishin shpenzuar 203,766€; dhe
- Çdo vit, të hyrat vetanake nuk shpenzohen si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit duke pas parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë 883,066€.



**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat vetanake	6,119,080	6,119,080	4,020,374	4,339,726	4,999,000

Siç shihet nga tabela 3, gjatë vitit 2013 të hyrat kanë shënuar një ulje prej 7% krahasuar me vitin 2012 apo 20% nga viti 2011. Planifikimi i të hyrave ishte i dobët, pasi që shkalla e mbledhjes gjatë vitit ishte vetëm 66%. Kjo ka ndikuar që shumë financime të parapara nga burimet vetjake të dështojnë.

### 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

#### Përshkrimi

Komuna grumbullon të hyra nga burime të ndryshme si: tatimi në pronë, taksa për regjistrimin e automjeteve, taksa e biznesit, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiratë, etj. Burimet më të vogla të të ardhurave përfshijnë regjistrimet e lindjeve dhe vdekjeve.

#### Çështja 6 - Të hyrat e planifikuara - Prioritet i lartë

**E gjetura** Të hyrat e planifikuara për vitin 2013 ishin 6,119,080€, ndërsa shumat e mbledhura 4,020,374€. Të hyrat e inkasuara gjatë vitit 2013 janë për 319,352€ më të ulëta se në vitin paraprak.

**Rreziku** Derisa në vitin 2012 dhe 2011 të hyrat duken të kenë pasur ecuri normale, në vitin 2013 kemi një rënie dëmthënëse të inkasimit të të hyrave vetanake. Rënia e vazhdueshme e të hyrave rrezikon edhe dështimin e projekteve të komunës, të planifikuara për t'u financuar nga të hyrat vetanake.

**Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

## Çështja 7- Mungesë e mekanizmave për mbledhjen e të hyrave - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2013 kishte planifikuar të inkasoj 1,370,000€, ndërsa ishin mbledhur 1,479,900€ apo 108% e të hyrave të planifikuara.

Ne analizuam aspektin e faturimit për Tatimin në Pronë për të vlerësuar çështjen e planifikimit. Vlera e faturuar për vitin 2013 është 2,096,919€, kurse komuna ka planifikuar të inkasoj vetëm 1,370,000€. Planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë nuk është bazuar as në faturimin e vitit aktual. Llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë deri në fund të vitit ishin 6,399,000€. Ne testuam 13 mostra nga tatimi në pronë në shumë prej 49,606€. Nga testimi nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi materiale, mirëpo komuna ende ka problem me inkasimin e borgjeve të grumbulluar prej vitit në vit.

**E gjetura** Sipas regjistrit kontabël të komunës të hyrat e planifikuara për taksën në firmë për vitin 2013 ishin 630,000€, ndërsa ishin mbledhur gjithsej 140,914€ apo rreth 22%. Edhe pse ishte nxjerrë një vendim në vitin 2012 për shlyerjen e 2/3 të borgjeve me rastin e pagesës prej 1/3 e borgjeve, informatat për borxhet nga vitet paraprake për taksën në biznes tregojne se borgjet ishin grumbulluar në shumën prej 4,343,000€. Inspektorët komunal nuk kishin arritur as përmes aktvendimeve dhe vizitave në terren, të ndikojnë në inkasimin e të hyrave nga taksa në firmë.

**E gjetura** Sipas të dhënave nga Thesari të hyrat e inkasuara për leje ndërtimi në vitin 2013, ishin 373,822€. Zyrtarët përgjegjës nuk ishin në gjendje të ofronin evidencë të plotë për të gjitha kërkesat për leje ndërtimi, si dhe të dhënat mbi numrin e kërkesave të aprovuara dhe të refuzuara.

**Rreziku** Planifikimi i ulët për inkasimin e të hyrave do të rrisë potencialin për mos pagesën e faturave të lëshuara dhe mungesa e një strategjie efektive për të mbledhur borxhin historik do të zvogëlojë aftësinë e Komunës për të ofruar projekte të vetë-financuara dhe për të përmbushur planet e tjera të shpenzimeve.

**Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj se planifikimi i të hyrave bazohet në parametra real me qëllim të stimulimit të mbledhjes të sa më shumë të hyrave vetjake. Po ashtu, duhet të zbatohet një rishikim sistematik për të përcaktuar barrierat për rritjen e shkallës aktuale të inkasimit të të hyrave dhe për zvogëlimin e shkallës së borxheve historike (duke përfshirë borxhet e tatimin për biznes) si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të situatës.

## 4.4 Shpenzimet

### 4.4.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Sipas rishikimit analitik, shpenzimet për investime kapitale gjatë vitit 2013, ishin 12,746,918€, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin 2,595,716€.

Për testim ne kemi marrë 55 pagesa për investime kapitale në shumë prej 5,248,788€ apo rreth 41% nga vlera e kontratave si dhe 17 pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 893,512€ apo rreth 26%.

---

#### Çështja 8 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

**E gjetura** Te Kontrata "Ndërtimi i stadiumit të qytetit" në shumë prej 193,623€, shumata e zotuar për këtë projekt ishte vetëm 20,000€. Raste të lidhjes së kontratave pa zotim të mjaftueshëm kemi gjetur edhe në 23 mostra të testuara. ZKF nuk kishte ndonjë koment për rastet e tilla;

Te kontrata "Asfaltimi i rrugës Piranë-Reti" në vlerë prej 167,137€ sipas planit dinamik, projekti ishte paraparë të përfundoj për 50 ditë pune. Ne kemi vërejtur se ky afat nuk ishte respektuar. Deri në kohën e auditimit, kjo vonesë kishte arritur në 250 ditë kalendarike. Sipas pohimeve të menaxhmentit mungesa e fondeve për këtë projekt ka bërë që të ngecë puna dhe si i tillë të mos përfundoj me kohë. Vonesa të tilla kemi gjetur pothuajse në secilin projekt të ekzaminuar.

**Rreziku** Nënshkrimi i kontratave pa sigurimin e mjaftueshëm të fondeve rrezikon moskryerjen e punimeve, në njërin anë, dhe e rritë rrezikun që komuna të futet në obligime pa fonde dhe si pasojë t'i nënshtrohet ndëshkimeve të caktuara. Mungesa e fondeve shkakton ngecjen e projekteve dhe për shkak të mungesës së fondeve, komuna nuk mund të zbatoj penale për ditët e vonesës.

**Rekomandimi 8** Kryetari i Komunës duhet të ketë parasysh rregullat financiare dhe të vendosë kontrolle më të forta te departamenti i financave dhe prokurimit që të parandalohet hyrja në obligime pa fonde. Krahas sigurimit paraprak të fondeve, menaxhmenti duhet të forcoj edhe kontrollet mbi monitorimin e kontratave.

---

## Çështja 9 - Dobësitë jo-sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Te kontrata "Ndërtim i rrugës Krushë e vogël - Piranë" në vlerë prej 74,855€ kemi gjetur se fituesi i tenderit ka ofruar sigurimin e ekzekutimit të kontratës për 40 ditë më të shkurt se sa plani dinamik i punimeve. Punimet nuk ishin kryer në afatin e garancionit, ndërsa komuna nuk kishte kërkuar ripërtëritjen e sigurimit të ekzekutimit. Sigurimi ishte bërë me datën 29.04.2013 deri me 08.06.2013 në shumë prej 7,405€.
- E gjetura** Në lëndën "Furnizimit me kripë industriale për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve" është lidhur kontrata me vlerë prej 19,920€. Ne kemi analizuar përmbajtjen e kontratës dhe kemi vërejtë se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk e ka sqaruar si duhet çështjen e furnizimit me kripë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve. Komuna ka paguar Operatorit Ekonomik (OE) vlerën prej 15,000€ për furnizim me kripë, por nuk është specifikuar se çka ndodhë nëse nuk ka të reshura dhe nuk ka nevojë për përdorimin e kripës dhe kush do të jetë pronar i kripës. Ne nuk kemi gjetur se kripa është në kuadër të depos së Komunës. Pra, liferimi i mallit nuk është bërë në depo të Komunës por, në kuadër të depos së OE-së.
- Rreziku** Një instrument i rëndësishëm i garantimit të implementimit të kontratës me kohë dhe cilësi është sigurimi i ekzekutimit. Në mungesë të sigurimit të ekzekutimit AK nuk e ka mundësinë për ta detyruar OE-në të sillet sipas kushteve të kontratës dhe rrezikon që kontrata të mos përmbushet.
- Mos specifikimi i qartë i kushteve të kontratës, mund të shkaktoj shpenzime të pa nevojshme dhe të dëmtoj fondet e komunës.
- Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se Departamenti i prokurimit zbaton të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, duke u siguruar se përmes sigurimit të ekzekutimit të obligoj OE që t'i përmbahet të gjitha kushteve të kontratës. Po ashtu, duhet të siguroj se Komuna vendosë objektiva të qarta para se të lidhë çfarëdo marrëveshje kontraktuale me OE, dhe sigurohet se kushtet e kontratës janë të favorshme dhe arsyetojnë vlerën për parane e shpenzuar.

## 4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrim

Janë disa aspekte të procesit të shpenzimeve tjera mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive.

---

### Çështja 10 - Mungesa e agjendës për udhëtime zyrtare - Prioriteti i lartë

**E gjetura** Me rastin e ekzaminimit të dy pagesave njëra në shumë prej 9,983€ dhe tjetra në shumë prej 2,772€, kemi vërejtur se pagesat janë bërë në emër të udhëtimit, përkatësisht vizitave në Shqipëri. Ne nuk kemi gjetur agjendën për këtë pjesëmarrje të 67 zyrtarëve komunal si dhe vendimin për arsyeshmërinë e këtij udhëtimi. Pagesa e dytë ishte bërë në emër të 14 grave të komunës për nder të festes së 8 marsit. Zyrtarët nuk ishin në gjendje të dëshmonin se shpenzimi për këtë aktivitet ishte i arsyeshëm.

**Rreziku** Mungesa e agjendës për pjesëmarrje të stafit komunal në Shqipëri si dhe mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimit, rrit rrezikun që paraja publike të shfrytëzohet në mënyrë të pa justifikueshme.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të shtoj kontrollet te llojet e ngjashme të shpenzimeve për të siguruar se shpenzimet janë në funksion të aktiviteteve operative të komunës, dhe si të tilla janë të bazuara dhe të arsyeshme.

## 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

### Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollet që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: autorizimin e sistemit të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme dhe barazimet e brendshme.

Buxheti për paga dhe mëditje për vitin 2013 ishte 15,151,373€, ndërsa ishin shpenzuar 15,139,594€, apo gati në tërësi. Për këtë kategori testuam 14 mostra ku rishikuam se a janë në pajtueshmëri listat e pagave me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike. Po ashtu, kemi testuar dosjet e personelit për të verifikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet janë në pajtueshmëri me kontratat dhe listës së pagave.

### **Çështja 11 - Personeli arsimor jashtë listës së pagave- Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Gjatë testimit të listës së të punësuarve në Arsim, kemi vërejtur se 21 të punësuar për punën e tyre nuk paguhen, ndonëse kishin kontratë pune. Këta të punësuar nuk figuronin në regjistrin e pagave. Stafi arsimor nuk realizon të drejta në paga për kontributet e dhëna.

**Rreziku** Angazhimi i stafit në procesin arsimor pa sigurimin e fondeve për paga, rrit rrezikun që stafi arsimor të mos paguhet me kohë. Kjo sjellë në vështirësi financiare stafin arsimor, dhe krahas kësaj, komuna mund të bëhet edhe subjekt i kontesteve gjyqësore.

**Rekomandimi 11** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se asnjë rekrutim i stafit nuk do të bëhet para se pagat të jenë të siguruara. Gjithashtu, rasti duhet të rishikohet dhe të gjitha pagesat ndaj stafit të bëhen sa më parë dhe praktikatat e tilla të mos përsëriten.

### **Çështja 12 - Obligime të papaguara për paga në QKMF dhe Arsim - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Sipas të dhënave në PVF, shuma totale e obligimeve të papaguara për paga dhe kompensime në fund të vitit ishte 213,000€. Nga kjo shumë 175,823€ i takojnë sektorit të arsimit ndërsa pjesa tjetër prej 35,000€ sektorit të shëndetësisë. Sipas pohimeve të zyrtareve komunal arsyeja për borxhet e papaguara ishte mungesa e mjeteve financiare.

**Rreziku** Planifikimi i pamjaftueshëm i fondeve për paga dhe kompensime tjera e vendosë komunën para rrezikut që të mos jetë në gjendje të paguaj për shërbimet e kryera dhe të ngarkojë buxhetin e vitit të ardhshëm me borxhe të vitit aktual.

**Rekomandimi 12** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se procesi i planifikimit të buxhetit për këta dy sektor është i ndërlidhur direkt me nevojat reale që kanë për mbulimin e pagave dhe mëditjeve, duke marrë në konsideratë përvojën e viteve paraprake.

### Çështja 13 - Mos përputhje e pagave me kontratë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Me rastin e testimit të 14 dosjeve të personelit kemi gjetur se te tre kontrata ekziston një mospërputhje në mes pagës sipas kontratës dhe pagës në sistemin e payrollit. Te dy të punësuar kemi gjetur se për 12 muaj të vitit 2013 ishin paguar më tepër për 576€, ndërsa te i treti i punësuar për 7 muaj sipas payrollit ishte paguar 364€ më shumë se paga e kontraktuar. Ne nuk kemi gjetur ndonjë vendim për ndryshimin e pagës, përkatësisht rritjen e koeficientit për këta 3 të punësuar.
- Rreziku** Zyra e personelit nuk ka azhurnuar dosjen e personelit dhe për pasojë kanë ndodhë pagesa jo korrekte.
- Rekomandimi 13** Kryetari i Komunës duhet të zgjidhë këtë jokonsistencë, dhe të përcaktoj nëse këto janë vetëm raste të izoluara apo një dukuri e përhapur. Varësisht nga gjendja, të forcohen edhe kontrollet për të parandaluar rastet e tilla.

#### 4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

##### Përshkrimi

Sipas rishikimit analitik, shpenzimet për subvencione gjatë vitit 2013 kanë qenë 504,157€. Për nevoja testimi, ne kemi shqyrtuar një njësi mostre të pagesave në vlerë prej 93,288€, apo rreth 19%.

Komuna posedon Rregullore për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve e cila është miratuar me 26.04.2013.

#### **Çështja 14 - Furnizimi para nënshkrimit të kontratës - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Komuna si subvencion ka ndarë pako me ushqime për stafin e vetë pa ndonjë bazë të qartë ligjore. Vlera e kontratës që ka nënshkruar Komuna për furnizim me pako ushqimore është 42,900€. Ne kemi gjetur listën me nënshkrime prej 436 punëtoreve, por nuk kemi mundur të verifikojmë artikujt dhe vlerat e furnizimit për secilin punëtor. Përzgjedhja e EO është bërë pa procedura të prokurimit, dhe për më tepër, është përzgjedhur kompania e cila i ka borxh komunës për qiranë e tokës.

Bazuar në vendimin e kryetarit më 16.10.2013, ishte financuar Klubi Futbollistik "Liria" në vlerë 15,000€. Përveç pagesës dhe vendimit nga kryetari për këto mjete, klubi nuk kishte paraqitur asnjë dokument si kërkesë, profaturë, planifikim të shpenzimeve apo listë pagash.

Ne një rast kemi vërejtur se ishte paguar shuma prej 14,799€ në emër të furnizimit me dru për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës duke mos bashkangjitur kërkesën dhe regjistrin e përfituesve.

Me rastin e testimi të dy pagesave njëra në shumë prej 12,239€ dhe tjetra në shumë prej 11,299€, kemi vërejtur se pagesat ishin bërë në bazë të furnizimit me material ndërtimor për raste sociale. Ne nuk na është ofruar regjistri i përfituesve me material ndërtimor.

**Rreziku** Mangësitë e identifikuar në rastet e mësipërme tregojnë se pagesat nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve nuk janë në pajtim me rregullat financiare. Nuk mund të konfirmohet nëse përfituesit kanë marrë kundërvlerat me të cilat ngarkohen në emër të ndihmave. Kjo rrit rrezikun që fondet e ndara për subvencione të mos arrijnë qëllimin, me mundësinë që në raste të caktuara, edhe të keqpërdoren.

**Rekomandimi 14** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se me rastin e marrjes së vendimit për subvencione të rishikohet baza ligjore. Gjithashtu ai duhet të siguroj se subvencionet, qofshin ato për furnizime me material apo transfere të mjeteve, të kërkojë nga drejtoritë përkatëse të mbajnë të gjitha informatat lidhur me përfituesit e këtyre subvencioneve dhe transfereve.



## 4.5 Pasuritë dhe obligimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Me datën 12.12.2013 ishte nxjerr vendim nga Kryetari i Komunës për formimin e komisionit për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive jo financiare, por ky komision ende nuk kishte finalizuar punën për të konstatuar gjendjen faktike mbi pasurit jo-financiare të komunës. Seksioni 2.3 përmban më shumë hollësi rreth pasurive.

---

#### Çështja 15 - Mungon raporti i inventarizimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Me vendim të Kryetarit të Komunës ishte caktuar komisioni për inventarizimit e pasurisë në fund të vitit. Ky komision nuk kishte përgatitur ndonjë raport mbi gjendjen fizike të pasurive jo-financiare.

**Rreziku** Mungesa e vlerësimit dhe inventarizimit të pasurive në fund të vitit, rrit rrezikun që në regjistrat e pasurisë të mbahen evidenca të pa sakta, ngase nuk mund të konfirmohet ekzistenca e pasurive. Në kushte të tilla, pasuria i ekspozohet rrezikut për humbje, keqpërdorim apo tjetërsim. Së këndejmi, raporti mbi pasuritë në PVF nuk mund të jetë i besueshëm.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të siguroj se komisioni i caktuar për inventarizim të pasurisë, brenda një periudhe të caktuar kohore do të bëj regjistrimin fizik të tyre për t'i krahasuar me gjendjen kontabël, dhe t'i sqaroj të gjitha diferencat eventuale. Gjithashtu, regjistrimi i pasurive me vlerë mbi 1,000€ duhet të jetë një proces që duhet të vazhdoj deri në regjistrimin final të të gjitha pasurive.

## 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

### Përshkrim

Komuna ka raportuar të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në shumë prej 6,399,000€, Licenca tjera afariste prej 4,343,000€, të arkëtueshmet nga tregjet prej 242,000€ dhe tarifa të tjera në shumë prej 673,000€. Pra, vlera totale e llogarive të arkëtueshmeve në fund të vitit 2013 ishte 11,657,000€.

---

### Çështja 16 - Mbledhja e të arkëtueshmeve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Në analizën për të hyrat, duket qartë se llogaritë e arkëtueshme kanë një tendencë rritjeje nga viti në vit, dhe atë tek të gjitha kategoritë e të hyrave. Shkalla e inkasimit sipas të gjitha bazave është nën mesatare dhe menaxhmenti i komunës nuk duket se ka një strategji si t'i çaset këtij problemi. Shuma e llogarive të pa arkëtuara prej 11,567,000€ është domethënëse për buxhetin e komunës. Është i pa kuptueshëm trendi i rënies së inkasimeve gjatë viteve. Psh. komuna në vitin 2011 kishte mbledhur nga tatimi në pronë 1 milion euro më shumë se në vitin 2013.

**Rreziku** Një planifikim i dobët i të hyrave dhe shkalla e ultë e inkasimeve ka ndikime direkte në realizimin e objektivave të përgjithshme të komunës, e në veçanti realizimin e projekteve kapitale nga të hyrat vetjake.

**Rekomandimi 16** Kryetari i komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për reduktimin në nivel të pranueshëm të këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicoj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

## 4.6 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte 2,485,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës buxhetore ngase Komuna kishte edhe detyrime kontingjente në shumë prej 2,087,000€. Borxhet e Komunës në fund të vitit 2013 kapin shumën totale prej 4,572,000€.

---

### Çështja 17 - Hyrja në detyrime përtej ndarjeve buxhetore - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas ekzaminimeve tona kemi vërejtur se komuna ka hyrë në obligime më shumë se ndarjet buxhetore. Fondi i ndarë për paga dhe mëditje ishte 15,151,373€, ndërsa detyrimet e mbetura ishin 213,000€. Shpenzimet komunale ishin 804,028 ndërsa obligimet e papaguara ishin 97,167€, më shumë se ndarjet buxhetore, si dhe shpenzimet për subvencione dhe transfere kishin tejkaluar buxhetin në shumë prej 43,178€. Këto shifra mund të jenë edhe më të larta bazuar në atë se gjatë vitit 2013 ishin paguar fatura të cilat nuk ishin prezantuar në PVF të 2012.

**Rreziku** Komuna nuk kishte arritur t'i trajtoj dhe menaxhoj borxhet si duhet dhe si pasojë e kësaj buxheti i vitit 2014, do të shpenzohet për pagesa për obligimet e mbetura të vitit 2013. Kjo flet për një planifikim të dobët dhe mos disiplinë financiare.

**Rekomandimi 17** Kryetari duhet të siguroj një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike.

## 4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm, prandaj ekzistimi dhe funksionimi i duhur i NJAB është pjesë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm.

NJAB-i për vitin 2013 kishte planifikuar pesë auditime, katër prej të cilave kanë mbuluar vitin 2013. Auditimet ishin të fokusuara në: në fushën e prokurimit, të hyrat vetjake, subvencioneve, auditimin në zyrën për komunitete dhe kthim, e cila ishte rekomanduar nga

---

Kryetari i Komunës. NJAB kishte përmbushur 80% planin e auditimit dhe si rezultat të përgjithshëm kishte arritur të nxjerrë disa rekomandime të vlefshme për menaxhmentin.

---

#### **Çështja 18 – Mungesë e implementimit të rekomandimeve - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Ne kemi vërejtur se menaxhmenti nuk ka pasur ndonjë Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve nga NJAB. Për të gjitha fushat e audituara, ishin dhënë edhe rekomandime përkatëse për përmirësim të proceseve, por që shkalla e zbatimit të tyre ishte mjaft e dobët.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime gjatë vitit 2013 dhe kishte shqyrtuar punën e auditorit të brendshëm. Nga procesverbalet e takimeve të komitetit është vërejtur se në mbledhjet e tyre ata kishin mbështetur punën e auditorit të brendshëm dhe kishin adresuar rekomandimet e tij për implementim. Gjithashtu ata kishin marrë në konsideratë edhe rekomandimet e dhëna nga raporti i auditimit të jashtëm për vitin e kaluar të adresohen plotësisht. Përkundër kësaj, menaxhmenti vetëm kishte marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna për vitin e kaluar si dhe këshillat e memorandumit të auditimit, por ato nuk ishin adresuar për implementim nga zyrtarët përgjegjës.

**Rreziku** Mungesa e gatishmërisë së menaxhmentit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm kanë ndikuar që shumë prej parregullsive të mos evitohen apo korrigjohen me kohë dhe si të tilla vazhdojnë edhe më tutje.

**Rekomandimi 18** Kryetari duhet të adresoj rekomandimet që dalin nga auditimet e brendshme, duke alokuar përgjegjësitë te stafi përgjegjës për implementimin e rekomandimeve të dhëna. Po ashtu, duhet të siguroj se përveç gatishmërisë për adresimin e rekomandimeve, ky proces në baza të rregullta edhe të monitorohet.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;

Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Plotësisht të adresuara	Pjesërisht të adresuara	Të pa adresuara
2.2 Cilësia dhe saktësia e PVF-ve	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që PVF-të për 2013 formalisht adresonjë të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë dhe përfshijnë rishikimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP në vitin 2012.		Pjesërisht	
3. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës të identifikuar me fokus fillesar në ato të një rëndësie më të madhe.	Po		
4.4 Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).		Pjesërisht	



	Kryetari i Komunës duhet ta krijojë një bazë të saktë të të dhënave se sa ka qenë numri i kërkesave për leje, lejet që janë lëshuar dhe ato që janë refuzuar. Po ashtu, rastet e tejkalimit të ndërtimeve duhet të rishikohen dhe si të tilla ose të ndërpriten ose të paguhen tarifatat shtesë.		Pjesërisht	
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se të gjitha obligimet kontraktuese zbatohen në baza të rregullta mujore nga qiramarrësit. Në të kundërtën, komuna duhet të ndërprej kontratat. Një rishikim i vazhdueshëm i kontratave dhe forcimi i kontrolleve duhet të bëhet nga menaxhmenti.			Jo
	Kryetari i Komunës duhet të shtojë aktivitetin për ta rritur inaksimin e borxheve të mbetura nga vitet paraprake.		Pjesërisht	
4.5 Shpenzimet	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se në të gjitha rastet e prokurimit, vlerësimi i ofertave bëhet në mënyrë objektive dhe në mënyrë strikte respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.		Pjesërisht	
	Kryetari i Komunës duhet të shqyrtoj arsyet pse kërkesat e prokurimit publik nuk janë aplikuar në këto raste dhe të sigurojë që janë vendosur kontrollet e duhura, në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten.	Po		
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se gjatë kërkesave për furnizime, fillimisht të bëhet një planifikim më i mirë i nevojave, në mënyrë që mos të ketë ndarje të tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit.			Jo
4.5.2 Pagat dhe Mëditjet	Kryetari i Komunës përmes mekanizmave të vetë duhet ta bëjë një shqyrtim sistematik të Dosjeve të Personelit, për të siguruar se të gjitha ndryshimet lidhur me stafin janë përfshirë, dhe pagesat janë azhurnuar. Pagesat e bëra tepër, duhet t'iu kthehen buxhetit të Kosovës brenda një periudhe të specifikuar kohore.		Pjesërisht	

4.5.3 Subvencionet dh Transferet	Kryetari i Komunës duhet që pa vonesë të miratoj një Rregullore që specifikon qartë kriteret, procedurat dhe burimet e subvencioneve.	Po		
	Kryetari i Komunës duhet që të siguroj se janë vendosur procedura dhe kontrole të duhura për shpenzimet e subvencioneve, në pajtim me ndarjet fillestare.		Pjesërisht	
4.6 Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë e blera të regjistrohen. Më tutje, të aplikojë procedura dhe kontrole të duhura në identifikimin e të gjitha pasurive të pranuar donacion dhe t'i regjistroj konform UA 21/2009.		Pjesërisht	
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do të forcojë kontollet tek menaxhimi i pasurive, duke respektuar kërkesat që dalin nga udhëzimi administrativ mbi menaxhimin e pasurive.		Pjesërisht	
4.7 Trajtimi i borxheve	Kryetari i Komunës përmes mekanizmave të vetë duhet të bëjë një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike.			Jo
5. Sistemi Auditimit të Brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të bëjë plan veprimi dhe të përcaktoj se si mendon të adresoj rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm. Po ashtu, menaxhmenti duhet të shqyrtoj plotësimin e NJAB me stafine nevojshëm.			Jo